



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi-Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Shtatë të Rishikimit të Paraburgimit

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr vendimin e mëposhtëm të rishikimit të paraburgimit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2020,¹ 25 janar 2021,² dhe 25 mars 2021,³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori përkatësisht “Vendimin për Rishikimin e Paraburgimit”, “Vendimin e Dytë të Rishikimit të Paraburgimit”, dhe “Vendimin e Tretë të Rishikimit të Paraburgimit”, ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Salih Mustafës (i akuzuari).

2. Më 25 maj 2021, 23 korrik 2021, dhe 23 shtator 2021, Trupi Gjykues nxori përkatësisht “Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit” (Rishikimi i Katërt i Paraburgimit)⁴, “Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit” (Rishikimi i Pestë i Paraburgimit),⁵ dhe “Vendimin e Gjashtë të Rishikimit të Paraburgimit (Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit).⁶ Në Rishikimin e Gjashtë të Paraburgimit, Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) si edhe mbrojtësen e viktimave, nëse dëshironte, të paraqisnin parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit brenda të hënës, 8 nëntor 2021, dhe Mbrojtjen, nëse dëshironte, të paraqiste parashtrimet e veta lidhur me sa më lart, brenda të hënës, 15 nëntor 2021.⁷

¹ KSC-BC-2020-05, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Rishikimin e Paraburgimit, 23 nëntor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00068, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit, 25 janar 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00097, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit (Rishikimi i Tretë i Paraburgimit), 25 mars 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykues I, Vendim i Katërt i Rishikimit të paraburgimit, 25 maj 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00158, Trupi Gjykues I, Vendim i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit, 23 korrik 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00215, Trupi Gjykues I, Vendim i Gjashtë i Rishikimit të Paraburgimit, 23 shtator 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i tij u dorëzua në të njëjtën ditë.

⁷ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 33 (b)-(c).

3. Më 8 nëntor 2021, ZPS-ja paraqiti parashtrimet e veta.⁸
4. Mbrojtësja e viktimave dhe Mbrojtja nuk paraqitën parashtrime.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se: (i) vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit mbetet i ligjshëm dhe i domosdoshëm, pasi dyshimi i bazuar vazhdon të ekzistojë dhe është realisht e mundshme që, nëse lirohet, i akuzuari mund të ndërhyjë ndaj viktimave, dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre dhe, në përgjithësi, mund të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor; dhe (ii) asnjë kusht nuk do të zvogëlonte në masë të mjaftueshme këtë rrezik.⁹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se rreziku i arratisjes dhe kryerjes së krimeve të tjera mbetet i lartë dhe, që prej rishikimit të fundit të paraburgimit, secili nga rreziqet e përmendura në nenin 41(6)(b) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) është rritur për shkak të nxjerrjeve të fundit të cilat zbulojnë informacione që identifikojnë të gjithë dëshmitarët e mbetur të Prokurorisë, ecurinë e gjykimit, dhe provat që dëshmitarët e Prokurorisë kanë dhënë gjatë dëshmive të tyre.¹⁰

6. Në lidhje me dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara (DHS), ZPS-ja parashtron se që nga Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit,¹¹ nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që mund të ndryshojë këtë konstatim të bërë si nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ashtu edhe nga Trupi Gjyqësor. ZPS-ja argumenton më tej se ky dyshim i bazuar mirë është përforcuar pas dëgjimit të provave të ofruara nga dëshmitarët fillestarë të

⁸ KSC-BC-2020-05, F00245, ZPS, Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Shtatë të Paraburgimit (Parashtrimet e ZPS-së), 8 nëntor 2021, konfidencial.

⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

Prokurorisë.¹² Në lidhje me rrezikun e arratisjes, ZPS-ja parashtron se: (i) një rrezik i tillë ekziston dhe mbetet i lartë për arsyet e paraqitura në Përgjigjen e saj lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit;¹³ (ii) pas dëshmive të fundit të dëshmitarëve dhe nxjerrjes së informacionit që identifikon dëshmitarët kryesorë të Prokurorisë, i akuzuari ka motiv edhe më të fortë për të mobilizuar rrjetin e tij mbështetës për ta ndihmuar të arratiset dhe të fshihet nëse lirohet;¹⁴ dhe (iii) lirimi i përkohshëm do të ishte i pamjaftueshëm për ta parandaluar një person me profilin, përvojën, dhe rrjetin e të akuzuarit që të arratiset, nëse ai do të vendoste ta bënte këtë gjë.¹⁵ Sa i takon rrezikut të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, ZPS-ja parashtron se ky rrezik jo vetëm që vazhdon të jetë i pranishëm, por është rritur për shkak të nxjerrjes kohët e fundit të identitetit të dëshmitarëve për Mbrojtjen.¹⁶ ZPS-ja argumenton më tej se njohja e identitetit të të gjithë dëshmitarëve të ZPS-së do të rrisë dukshëm rrezikun e pengimit të procesit gjyqësor nga i akuzuari apo rrjeti i tij dhe dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjua deri më sot konfirmojnë ndikimin e të akuzuarit në Kosovë dhe aftësinë e tij për të ndikuar ndaj dëshmitarëve, dhe për pasojë dhe në procesin gjyqësor.¹⁷ Prandaj, ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e të akuzuarit mbetet thelbësore për ta zvogëluar një rrezik të tillë.¹⁸

7. Në lidhje me rrezikun e kryerje së krimeve të tjera, ZPS-ja u referohet parashtrimeve të mëparshme të saj dhe argumenton se rreziku i kryerjes së krimeve

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4, i referohet KSC-BC-2020-05, F00122, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit* (Përgjigje e ZPS-së lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit), 17 maj 2021, publik.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, poshtëshënimi 8.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5-6.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

të tjera veçse është rritur më shumë me nxjerrjen e informacionit identifikues të dëshmitarëve për Mbrojtjen dhe të akuzuarin.¹⁹

8. ZPS-ja parashtron më tej se rreziqet që paraqet i akuzuari mund të trajtohen efektivisht vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së, veçanërisht në këtë fazë të avancuar të procesit gjyqësor.²⁰ Asnjë nga garancitë që mund të ofrojë i akuzuari nuk do të mjaftonte për eliminimin ose zvogëlimin e rreziqeve ekzistuese.²¹ Së fundi, ZPS-ja thekson se konstatimet e mëparshme të Trupit Gjyqësor lidhur me arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së paraburgimit në këtë çështje gjyqësore janë ende të vlefshme.²²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Trupi Gjyqësor mbështetet në nenet 29, 31(5), dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), nenet 3(2), 21(3), dhe 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").

IV. ANALIZË

10. Në fillim, Trupi Gjyqësor rikujton se prezumimi i pafajësisë, i paraparë në nenin 31(5) të Kushtetutës, nenin 21(3) të Ligjit, dhe nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa), është pikënisja për vlerësimin e vazhdimin të paraburgimit.²³ Për këtë arsye, vazhdimi i paraburgimit nuk mund

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10, i referohet edhe Parashtrimeve të ZPS-së lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, para. 11-12 dhe KSC-BC-2020-05, F00147, ZPS, Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit, 5 korrik 2021, publik, para. 8.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11-12.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-14, duke iu referuar Rishikimit të Gjashtë të Paraburgimit, para. 30-32.

²³ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 13; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 13; *Shih* edhe KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (Vendim mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm), 30 prill 2021, publik, para. 17.

të vendoset me lehtësi dhe i akuzuari duhet të lirohet në momentin që mbajtja e tij në paraburgim nuk është më e arsyeshme.²⁴

A. DYSHIMI I BAZUAR

11. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit përcakton si parakusht,²⁵ ekzistencën e dyshimit të bazuar se është kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së.²⁶

12. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta të mëparshme se, për vetë vendimin e marrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës kundër të akuzuarit,²⁷ kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit është përmbushur dhe konfirmuar nga një autoritet i pavarur gjyqësor pas analizimit të provave të paraqitura nga ZPS-ja.²⁸ Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se vlerësimi i provave mbi të cilat mbështeten akuzat do të do kryhet gjatë gjykimit, kur do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e të akuzuarit në bazë të tërësisë së provave përpara Trupit Gjykses.²⁹ Për më tepër, Trupi Gjykses nuk identifikon asnjë arsye për të konstatuar se konfirmimi i aktakuzës kundër të akuzuarit ishte i papërshtatshëm ose i mangët, deri në masën që

²⁴ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 13; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 13; Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Buzadji v. The Republic of Moldavia*, no. 23755/07, [Judgment](#) [GC] (*Buzadji v. The Republic of Moldavia* [GC]), 5 July 2016, para. 90.

²⁵ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14; ECtHR/GJEDNJ, [Buzadji v. The Republic of Moldavia](#) [GC], para. 87.

²⁶ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14 dhe poshtëshënimi 28.

²⁷ KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 5 tetor 2020, publik, para. 163(a).

²⁸ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14, i referohet KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik, para. 1; F00009/RED dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, publik, para. 18.

²⁹ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Tretë i Paraburgimit, para. 12.

standardi i dyshimit të bazuar nuk përmbushet më.³⁰ Rrjedhimisht, dhe në vijim të dëshmive të dëshmitarëve të dëgjua deri më sot dhe materialeve të tjera mbështetëse, Trupi Gjykes konstaton se kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit nuk ka pushuar së ekzistuari dhe për këtë arsye vazhdon të përmbushet.

B. DOMOSDOSHËRIA E PARABURGIMIT

13. Trupi Gjykes rikujton standardin e zbatueshëm në lidhje me vlerësimin nëse vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit është i domosdoshëm, siç përcaktohet në Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, si dhe rëndësinë e arsytimit specifik (në bazë të rrethanave të çështjes gjyqësore) dhe arsytet konkrete mbi të cilat duhet të mbështetet Trupi Gjykes në marrjen e vendimit, siç ka theksuar Paneli i Gjykatës së Apelit.³¹

14. Në veçanti, sa i përket nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Trupi Gjykes rikujton se, sikurse në lidhje me të gjitha rreziqet e tjera të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, ajo që duhet të kryejë Trupi Gjykes është vlerësimi i rrezikut.³² Në këtë kontekst, për të vlerësuar nëse rreziku i pengimit mund të jetë i pranishëm në të ardhmen, nuk ka nevojë të vërtetohet se realisht ka pasur pengim në të shkuarën.³³

1. Rreziku i arratisjes

15. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Trupi Gjykes rikujton konstatimet e tij të mëparshme se i akuzuari nuk përbën rrezik arratisjeje

³⁰ *Ngjashëm*, Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 15; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14.

³¹ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 16; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 16; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 15-17, i referohet edhe Vendim mbi Apelin e *Thaçit* lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, para. 22.

³² Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 17; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 17; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 17.

³³ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 17; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 17; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 17. *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 38.

dhe se një rrezik i tillë, edhe në rast se është i pranishëm, mund të zvogëlohet në masë të mjaftueshme me anë të kushteve që i caktohen atij.³⁴

16. Trupi Gjykses më tej vë në dukje parashtrimin e ZPS-së se i akuzuari ka motiv më të fortë për të mobilizuar rrjetin e tij mbështetës për ta ndihmuar të arratiset dhe të fshihet, pas dëgjimit të dëshmimeve të fundit të dëshmitarëve dhe nxjerrjes së informacionit. Megjithatë, Trupi Gjykses nuk e konsideron këtë faktor të mjaftueshëm për përcaktimin e rrezikut të arratisjes. Kur vlerëson rrezikun e arratisjes, Trupi Gjykses thekson faktorë të tjerë të vlerësuar më parë, siç është bashkëpunimi i të akuzuarit me ZPS-së përpara konfirmimit të aktakuzës dhe lidhjet që ka ai me vendin e tij,³⁵ dhe gjykon se nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që vë në dyshim konstatimet e mësipërme të Trupit Gjykses.

17. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se i akuzuari nuk përbën rrezik arratisje dhe se një rrezik i tillë, edhe në rast se është i pranishëm, mund të zvogëlohet në masë të mjaftueshme me anë të kushteve që i caktohen atij në bazë të nenit 41(12) të Ligjit dhe rregullës 56(5) të Rregullores.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së

18. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së të përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Trupi Gjykses vlerëson se shumica e faktorëve të rrezikut të theksuar më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes, janë të rëndësishëm në kontekst të këtij rreziku. Në veçanti, Trupi Gjykses është i mendimit se dijenia e të akuzuarit për akuzat dhe mundësia e një dënimi me burgim të gjatë, nëse shpallet fajtor, mund t'i shërbejë si motiv të akuzuarit për të ndërhyrë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre nëse lirohet.

³⁴ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 18; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para 19; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 18.

³⁵ Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 18, Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para 18.

Duke pasur parasysh lidhjet e të akuzuarit me aparatit e zbulimit në Kosovë dhe përvojën e tij në këtë drejtim, dhe më tej [REDAKTUAR],³⁶ dhe [REDAKTUAR],³⁷ një ndërhyrje e tillë mund të realizohet, ndër të tjera, përmes: (i) ushtrimit të trysnisë, duke përfshirë përmes dhunës dhe kërcënimeve, ose orvatjeve për të ushtruar ndikimin ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre; (ii) frikësimit të viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes të tjerëve; dhe/ose (iii) bashkëpunimit me kryes të tjerë të mundshëm të përmendur në aktakuzën e konfirmuar, apo me këdo tjetër të përfshirë në këtë çështje apo çështje të tjera gjyqësore. Kjo vlen akoma më shumë në këtë fazë të procesit gjyqësor, duke pasur parasysh nxjerrjen e informacionit të mëtejshëm së fundi dhe në vazhdimësi për të akuzuarin, në veçanti nxjerrjen e identitetit të të gjithë dëshmitarëve të ZPS-së, duke përfshirë dhe ish-anëtarë të UÇK-së që kanë vepruar në të njëjtën zonë me të akuzuarin. Sipas mendimit të Trupit Gjyqësor, kjo do ta bënte më lehtë për të akuzuarin, i cili është oficer zbulimi me përvojë dhe ka njohuri teknike dhe rrjetin e nevojshëm, të mund të ndërhyjë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre, dhe në përgjithësi, të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor. Gjithashtu, kuadri i kufizuar i kësaj çështjeje gjyqësore dhe i numrit të dëshmitarëve, si edhe fakti që provat e një dëshmitari shpesh janë në mënyrë të pandashme të lidhura me provat e dëshmitarëve të tjerë, mund të zmadhojnë rrezikun e ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre.

19. Trupi Gjyqësor vëren më tej se gjatë dëshminë së tij, [REDAKTUAR].³⁸ Përveç kësaj, Trupi Gjyqësor thekson se, gjatë dëshmisë së tij, [REDAKTUAR],³⁹

³⁶ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 14 tetor 2021, konfidencial, f. 1232, rreshti 25 deri në f. 1233, rreshti 2; f. 1239, rreshtat 9 – 16 dhe f. 1240, rreshtat 4 – 8.

³⁷ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 18 nëntor 2021, konfidencial, f. 1686, rreshti 23 deri në f. 1688, rreshti 21.

³⁸ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 5 tetor 2021, konfidencial, f. 994, rreshtat 11-22.

³⁹ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 24 shtator 2021, konfidencial, f. 771, rreshtat 2-4.

[REDAKTUAR].⁴⁰ Trupi Gjykues konstaton se rrethana të tilla janë tregues i influencës që ka i akuzuari në Kosovë dhe aftësisë së tij për të ndikuar ndaj dëshmitarëve, dhe rrjedhimisht dhe ndaj procesit gjyqësor.

20. Trupi Gjykues vë në dukje më tej se gjatë dëshmime të tyre, [REDAKTUAR].⁴¹ Edhe pse ky faktor në vetvete nuk është përcaktues në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit gjyqësor, ai ofron kontekstin kundrejt të cilit duhet të merren parasysh konstatimet e mësipërme, të cilat veçanërisht kanë lidhje me të akuzuarin.

21. Së fundi, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e tij të përsëritur se [REDAKTUAR],⁴² gjë që e bëri Trupin Gjykues të urdhërojë [REDAKTUAR].⁴³ Ky është një argument tjetër i fortë kundër lirimit të të akuzuarit.

22. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues gjykon se rreziku që i akuzuari mund të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor të DHS-së përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre vazhdon të ekzistojë.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

23. Trupi Gjykues rikujton se, meqë kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit, me përmbushjen e njërit prej këtyre kushteve nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera për vazhdimin e masës së paraburgimit.⁴⁴

⁴⁰ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 24 shtator 2021, konfidencial, f. 771, rreshtat 5-7.

⁴¹ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1487, rreshti 16 deri në f. 1489, rreshti 1; f. 1490, rreshti 18 deri në f. 1492 rreshti 8; f. 1494, rreshtat 11 – 21 dhe f. 1495, rreshti 11 deri në f. 1496, rreshti 11; KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 18 nëntor 2021, konfidencial, f. 1712, rreshti 1 deri në f. 1714, rreshti 9.

⁴² [REDAKTUAR].

⁴³ [REDAKTUAR].

⁴⁴ Vendim mbi Apelin e *Thaçit* lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 78.

24. Pasi ka konstatuar se ka mundësi mjaftueshmërisht reale që i akuzuari të pengojë procesin gjyqësor të DHS-së, ndër të tjera përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve e tyre,⁴⁵ Trupi Gjykses konstaton se nuk ka nevojë të shqyrtojë rrezikun e përcaktuar në nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.⁴⁶

4. Përfundim

25. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së, përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, vazhdon të ekzistojë.

C. LIRIMI ME KUSHT

26. Trupi Gjykses rikujton se masa e paraburgimit duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ka masa më të buta që mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.⁴⁷ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka detyrimin të shqyrtojë dhe të vlerësojë, *proprio motu*, të gjitha kushtet e arsyeshme që mund t'i caktohen një të akuzuari.⁴⁸

27. Sa i takon rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së, Trupi Gjykses rikujton faktorët e rrezikut të identifikuar më lart.⁴⁹ Trupi Gjykses rikujton më tej konstatimet e veta se [REDAKTUAR],⁵⁰ gjë që e bëri Trupin Gjykses të urdhëronte:

⁴⁵ *Shih më lart* para. 18-22.

⁴⁶ *Ngjashëm*, Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 24; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 24; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 22.

⁴⁷ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 26; Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 26; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 24; KSC-CC-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj, publik, para. 70.

⁴⁸ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 26, Rishikimi i Pestë i Paraburgimit, para. 26; Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 24. *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 86.

⁴⁹ *Shih më lart* para. 18-22.

⁵⁰ [REDAKTUAR].

(i) [REDAKTUAR];⁵¹ dhe (ii) [REDAKTUAR].⁵² Nëse i akuzuari lirohet, Trupi Gjykes gjykon se asnjë kusht nuk mund të sigurojë kufizimin ose monitorimin e duhur të komunikimeve të tij private, përfshirë me anëtarët e familjes së tij dhe vizitorët e miratuar, të cilët mund të përdoren për të kërkuar ose marrë informacione dhe burime që lehtësojnë ndërhyrjen ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre; asnjë prej këtyre kushteve nuk mund të zbatohet siç duhet dhe as të monitorohet mjaftueshëm. Konkretisht, duke rikujtuar se i akuzuari ka aftësi të veçanta për shkak të përvojës së tij në zbulim, ekziston mundësia reale që ai mund t'u kërkojë të tjerëve të transmetojnë një mesazh gojarisht, ose të përdorë një aparat që i përket një pale të tretë për ta bërë këtë. Për më tepër, pavarësisht pyetjes nëse ndonjëri prej këtyre kushteve mund të zbatohet efektivisht në praktikë, çdo kusht tjetër, i tillë si vizitat e monitoruara, do të zvogëlonte mjaftueshmërisht rrezikun për shkak të mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar që nuk mund të identifikohet ose të parandalohet lehtësisht nga persona që nuk i njohin proceset e DHS-së. Për rrjedhojë, komunikimet e të akuzuarit mund të kufizohen dhe të monitorohen efektivisht vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe [REDAKTUAR].

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se asnjë kusht, përfshirë ato të propozuara më parë nga Mbrojtja, si edhe asnjë kufizim shtesë që mund të vendosë Trupi Gjykes, nuk do të zvogëlonin në masë të mjaftueshme rrezikun e pengimit të ecurisë së proceseve gjyqësore të DHS-së. Për këtë arsye, i akuzuari duhet të mbetet në paraburgim.

⁵¹ [REDAKTUAR].

⁵² [REDAKTUAR].

D. ARSYESHMËRIA E KOHËZGJATJES SË PARABURGIMIT

29. Trupi Gjykues rikujton detyrimet e veta, sipas rregullës 56(2) të Rregullores, të sigurojë që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes gjyqësore, dhe të gjykojë në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në nenin 3(2) dhe (e) të Ligjit.⁵³ Për rrjedhojë, Trupi Gjykues gjykon se ai do të vazhdojë të vlerësojë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së paraburgimit të të akuzuarit pas hapjes së çështjes gjyqësore, e cila ndodhi më 15 shtator 2021,⁵⁴ deri kur të jetë marrë një vendim mbi akuzat e ngritura kundër tij, ose deri kur procesi gjyqësor të ketë përfunduar, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).⁵⁵

30. Në rrethanat e çështjes gjyqësore aktuale, Trupi Gjykues vëren se i akuzuari ndodhet në paraburgim për 14 muaj që prej arrestimit dhe transferimit të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë, më 24 shtator 2020. Trupi Gjykues vëren më tej se i akuzuari akuzohet për krime të rënda lufte sipas nenit 14 të Ligjit, përfshirë për vrasje dhe torturë, që pretendohet se janë kryer sipas shumë formave të përgjegjësisë penale në bazë të nenit 16 të Ligjit. Trupi Gjykues nuk ka identifikuar asnjë periudhë ndërprerjeje në procesin kundër të akuzuarit para DHS-së, që do ta çonte në përfundimin se kohëzgjatja e paraburgimit është e paarsyeshme. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se: (i) gjykimi filloi, siç ishte planifikuar, më 15 shtator 2021, sipas procedurës së përcaktuar në rregullën 124 dhe 125 të Rregullores, vijuar prej deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së

⁵³ Rishikimi i Gjashtë i Paraburgimit, para. 30.

⁵⁴ Transkript i seancës, 15 shtator 2021, publik, f. 301-382.

⁵⁵ *Shih, p.sh.*, ECtHR/GJEDNJ, *Solmaz v. Turkey*, no. 27561/02, [Judgment](#), 16 January 2007, paras 23-24; [Kalashnikov v. Russia](#), no. 47095/99, 15 July 2002, para. 110; [Wemhoff v. Germany](#), no. 2122/64, 27 June 1968, para. 9, noting that, in determining the length of detention pending trial under Article 5(3) of the Convention, the period to be taken into consideration begins on the day the accused is taken into custody and ends on the day when the charge is determined, even if only by a court of first instance.

viktimave; dhe (ii) deri më sot, Trupi Gjykses ka dëgjuar dëshminë e shtatë (7) dëshmitarëve të ZPS-së, dy (2) në shtator 2021;⁵⁶ dy(2) në tetor 2021⁵⁷ dhe tre (3) në nëntor 2021.⁵⁸ Mbi të gjitha, Trupi Gjykses vëren se palët synojnë të thërrasin një numër të kufizuar dëshmitarësh.

31. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjykon se i akuzuari mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme.

V. VENDIM

32. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit;
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësen e viktimave, nëse dëshiron, të paraqesin parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit brenda të mërkurës, 12 janar 2022;
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, nëse dëshiron, brenda të hënës, 17 janar 2022.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

⁵⁶ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 20 shtator 2021, publik; KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 23 shtator 2021, publik.

⁵⁷ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 4 tetor 2021, publik; KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 12 tetor 2021, publik.

⁵⁸ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 2 nëntor 2021, publik; KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 10 nëntor 2021, publik; Transkript i seancës, 17 nëntor 2021, publik.

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhiber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E martë, 23 nëntor 2021

Në Hagë, Holandë.